



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 58 datë 30-04-2026

**PËR FINANCIMIN ME 2 VITE BUXHETORE (2026-2027), TË OBJEKTIT
“SHTRIM ME ASFALT MIKS I RRUGËVE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE,
BASHKIA KORÇË”**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës si dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK, me objekt “Për financimin me 2 vite buxhetore (2026-2027), të objektit Shtrimi me asfalt miks i rrugëve të Njësive Administrative, Bashkia Korçë”, duke iu referuar ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, ligjit nr 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 « Për financat e vetëqeverisjes vendore », i ndryshuar, ligjit nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, Udhëzimit Plotësues nr. 2 datë 14.1.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”, VKB nr. 139 datë 26.12.2025 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë”, i ndryshuar, si dhe urdhrin nr. 13 datë 7.1.2026 “Për detajimin e shpenzimeve për investime për vitin 2026 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë”, mbështetur në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë financimin me 2 vite buxhetore (2026-2027) të investimit me objekt “Shtrimi me asfalt miks i rrugëve të Njësive Administrative, Bashkia Korçë”, si më poshtë dhe me këtë strukturë buxhetore:

/lekë

Objekti	Financimi 2026	Financimi 2027	Total
Shtrim me asfalt miks i rrugëve të Njësive administrative, Bashkia Korçë	41,898,111	41,898,111	83,796,222
Mbikqyrje e punimeve për objektin Shtrim me asfalt miks i rrugëve të Njësive administrative, Bashkia Korçë	912,646		912,646
Kolaudimi I punimeve për objektin Shtrim me asfalt miks i rrugëve të Njësive administrative, Bashkia Korçë	136,897		136,897
Total	42,947,654	41,898,111	84,845,765

Prog. AE122 00 P452AAC 05 Art. 2310000 (Bashkia)

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës si dhe Drejtoria e Prokurimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 3

Zbardhur më datë 30-04-2026

KRYETAR

Ana Verushi

